

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	Ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili	<b>DATE DATUM DATE</b>	16/01/2019
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Mimoza Kusari – Lila, Deputete e Alternativës		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:** Ligji për Nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit është miratuar në Maj të vitit 2013. Me fillimin e zbatimit të ligjit është vërejtur një shkallë e kënaqshme e zbatueshmërisë, me degradim të theksuar dy vite pas.

**Pyetje:**

1. Ministër, Çka ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë gjatë mandatit tuaj për zbatimin e mirëfilltë të këtij ligji?
2. Pse nuk po zbatohet ligji për kontrollin e duhanit në respektimin e ndalimit të pirjes së duhanit në vende publike?
3. Këshilli ndërministror për kontrollin e duhanit, A ka pasë takim dhe a ka koordinim të palëve pjesëmarrëse gjatë mandatit tuaj?
4. A keni reaguar ndonjëherë Ju si Ministri përgjegjës në heqjen e shtojcave të lokaleve, të cilat janë të mbyllura dhe përdoren enkas për tymosje në kundërshtim të plotë me Ligjin për Kontrollin e Duhanit?



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-EPUR  
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA  
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO  
Zyra për Propozime dhe Parashitje-Kancelaria e Prokurorisë dhe Prokurorisë së Shtetit

Nr. Prot. 06/2707/D<sub>0</sub>-1372  
Br. Prot.  
Prot. No.

Data 24.01.2019  
Datum  
Dat.

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**


<b>PËR / ZA / TO</b>	Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj,	<b>DATE DATU M DATE</b>	24.01.2019
		Reference	01/17
<b>NGA / OD / FROM</b>	Naser Rugova - Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së		
<b>SUBJE KTI PREDM ET SUBJE CT</b>	Pyetje parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:** Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi është ratifikuar me datën 21.03.2018 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në këtë marrëveshje ndërshtetërore është paraparë që në afatin kohor prej dy vitesh të rishikohet vija kufitare në mes të dy shteteve.

**PYETJA:** Z. Kryeministër, po bëhen gati një vit nga ratifikimi i marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, cilat janë veprimet e Komisionit Shtetëror të Kosovës sa i takon kësaj çështje dhe a ka hapa konkret sa i takon vijës kufitare Kosovë - Mal i Zi.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	z.Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë	<b>DATË DATUM DATE</b>	25.01.2019
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Drita Millaku, deputete e Lëvizjes VETËVENDOSJE! <i>Millaku</i>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

### ÇËSHTJA

Gjendja e Repartit të Radiologjisë në spitalin e Prizrenit

### PYETJE PARLAMENTARE

Ministër,


A e keni vizituar spitalin e Prizrenit, konkretisht repartin e radiologjisë, nëse po çfarë do të ndërmerri për të përmirësuar situatën?



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
SKUPSTINA REPUBLIKE KOSOVA  
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO  
Zyra për Propozime dhe Përshkrime-Kancelaria për Propozime dhe Përshkrime-Table Office

Nr. Prot. R. Prot. No. 06/2732/0-1390  
Nr. i fondeve Biri, transico No. pagesi Data Datum Date 28.01.2019  
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Valdrin Lluka, Ministër i Zhvillimit Ekonomik	<b>DATE DATUM DATE</b>	28.01.2019
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Glauk Konjufca, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJEJ 		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		


Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

### ÇËSHTJA

Prej 6 muajsh është në fuqi Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për Telekomin dhe postën. Prej 6 muajsh ju dhe ministria juaj nuk e keni bërë asnjë hap në drejtim të zbatimit të saj. Përkundrazi keni sugjeruar qeverisë hyrjen në procesin e privatizimit.

### PYETJE PARLAMENTARE

Mbi ç'bazë po e shkelni vendimin e Kuvendit i cili ju detyron të zbatoni pikë për pikë rezolutat e Kuvendit të Republikës së Kosovës?



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. <i>Valdrin Lluka</i> , Ministër i Zhvillimit Ekonomik	<b>DATE DATUM DATE</b>	28.01.2019
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Glauk Konjufca, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJEV <i>Konjufca</i>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**ÇËSHTJA**

Transformatori energjetik në nënstacionin e Trepçës

**PYETJE PARLAMENTARE**

A mund të na njoftoni me hollësitë, shkaqet dhe masat e marra për riparimin e avarisë që pësoi transformatori energjetik në nënstacionin Trepça ku u rrezikuan minatorët brenda minierës dhe mbeti 4 ditë pa energji elektrike e furnizim të rregullt me ujë Komuna e Mitrovicës së jugut?





KOSOVA REPUBLICA E KOSOVË - REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA  
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO  
Prishtinë / Pristina - Kancelaria e Kuvendit / Pristina - Pristina - Table Office

No. Prot. / B. Prot. / Prot. No. 06/2735 / 10-1393  
Data / Datum / Date 28.01.2019  
PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Ramush Haradinaj, Kryeministër i Republikës së Kosovës	<b>DATE DATUM DATE</b>	28.01.2019
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Xhelal Sveçla, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

### ÇËSHTJA

Ndërmarrja e re energjetike

### PYETJE PARLAMENTARE


Kontrata me ContourGlobal është në disfavor të interesit të Kosovës, po ashtu Kuvendi nuk i ka dhënë miratim në asnjë version këtij projekti. Ju keni shpallur konkurs për bordin e një ndërmarrje të re energjitike që planifikohet sipas projektit tuaj të blej 100% të energjisë që supozohet të prodhojë contour global, mbi cilën bazë po themeloni Ndërmarrja e re energjitike?




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Kuvendi – Skupština – Assembly

**KORAB R. SEJDIU**

Deputet  
Poslanik – Representative



<b>Për / Za / For:</b>	Z. Uran Ismaili, Ministër Ministria e Shëndetësisë
<b>Nga / Od / From:</b>	Korab R. Sejdiu, Deputet
<b>Data / Datum / Date:</b>	28 janar 2019 
<b>Referenca / Referenca / Reference:</b>	01/2019
<b>Lënda / Predment / Subject:</b>	Pyetje parlamentare për përgjigje me gojë

Në bazë të Nenit 45 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e rradhës.

**Çështja:** Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, që ka hyrë në fuqi më 22 maj 2013, ndër të tjera në Nenin 11 ndalon pirjen e duhanit në hapësira publike, që definojnë në Nenin 2.1.11 si “hapësirë e mbyllur e cila i dedikohet qëndrimit të dy apo më shumë njerëzve dhe përfshin hapësirat në të cilat kryhen aktivitetet nga lëmi i shëndetësisë, sociale, edukative, arsimore, sportive dhe rekreative, kulturore, artistike, lokaleve hoteliere e shërbyese, hapësirave për pritje, mbledhje e takime, vende të punës me pronësi publike ose private, të gjitha sallat për tubimin e njerëzve dhe mjetet e transportit publik.” Me përjashtim të shumë pak hapësirave publike, kjo ndalesë ligjore nuk zbatohet po thuajse askund (përfshirë këtu edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës), e veçanërisht në lokalet hoteliere dhe shërbyese. Ky problem bëhet edhe më evident gjatë muajve të dimrit, duke rritur dukshëm dëmin që i shkaktohet personave të pranishëm në këto hapsira publike.

**PYETJA:** Z. Ministër, duke pasë parasysh se pjesa kryesore e zbatimit të këtij obligimi ligjor bie mbi Ministrinë që ju drejtoni, çfarë hapa konkret keni ndërmarrë ose do të ndërmerrni, që të siguroheni që ligji në fjalë të zbatohet në plotni (me shpresë që përgjigja juaj të mos inkorporojë ankesën se nuk keni inspektorë të mjaftueshëm, pasi që përgjegjësia e juaj përfshinë edhe sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme për funksionimin adekuat të Ministrisë që drejtoni), cilët janë ata hapa, dhe brenda çfarë afateve kohore?

Email: Korab.Sejdiu@assembly-kosova.org  
Tel: +377 (0)44 470 045  
Skype: korab.r.sejdiu

Ndërtesa e Kuvendit  
Sheshi Nëna Tereze  
Kutia/Box 70  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

KUVENDI REPUBLICAN OF KOSOVO  
SKUPŠTINA REPUBLICHE KOSOVA  
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO  
Propozim i Propozitave Kushtetuese - Trajtim i Propozitave Table Office  
Nr. Dokumenti: 06/2743/19-1398  
Data: 28.01.2019

<b>PËR / ZA / TO</b>	Ministrinë e Shëndetësisë Uran Ismailin	<b>DATE DATUM DATE</b>	28.01.2019
<b>NGA / OD / FROM</b>	Deputeti: Bekim Haxhiu <i>Bekim Haxhiu</i>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja :

I nderuar ministër Ismaili,

Në Kosovë janë rreth 1 400 persona të prekur nga sëmundja Skleroza Multiple, por vetëm 100 prej tyre përfitojnë shërbime falas nga Ministria e Shëndetësisë . Deri me tanin medikamentet për trajtimin e kësaj sëmundje nuk janë të përfshira në Listën e Barnave Esenciale. Personat e prekur nga SM janë të moshës së re 20-40 vjeç. Skleroza Multiple (SM) është sëmundje autoimune e cila e atakon sistemin nervor qëndror. Skleroza Multiple është sëmundje e cila nuk mund të shërohet por vetëm menaxhohet, në vendet e rajonit trajtohet falas, por jo edhe në Kosovë për të gjithë pacientët. Ekzistojnë 14 terapi të aprovuar për trajtimin e kësaj sëmundje por në Kosovë jepet vetëm një lloj i kësaj terapie për 100 persona, por të tjerët duhet ta blejnë vet ose të mos trajtohen fare.

I nderuar Ministër, pacientët e prekur nga Skleroza Multiple kanë bërë kërkesë për përfshirjen e medikamenteve të kësaj sëmundje në Listën e Barnave Esenciale, kërkesë kjo e cila do të duhej të trajtohej nga Komiteti për hartimin e Listës se Barnave Esenciale.

PYETJE :

Cfarë është duke bërë MSH për të trajtuar të gjithë pacientët e prekur me Sklerozën Multiple në Kosovë, dhe ato të jetë në Listën e Barnave Esenciale terapia për trajtimin e Sklerozen Multiple?





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
 KUVENDI I REPUBLIKES SË KOSOVËS  
 SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA  
 ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO  
 Zyra për Propozime dhe Parashitje - Kancelaria za Predloge i Predstavke-Table Ofi.  
 Nr. Prot. 06/2793/10-14/18  
 St. Prot. Prot. No:  
 Nr. i faqeve 07-02-2019  
 Prishtinë - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës  
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
 Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Abelard Tahiri, Ministër i Drejtësisë	<b>DATE DATU M</b>	06.02.2019
		<b>DATE Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM SUBJE KTI PREDM ET SUBJE CT</b>	Doruntinë Maloku, Deputete e Grupit Parlamentar të LDK-së	<i>[Signature]</i>	
	Pyetje Parlamentare		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e rradhës së Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:** Komuna e Istogut ka rreth 50 mijë banorë, të cilët po përballën me probleme të shumta për shkakë të mungesës së noterëve, për të kryer shërbimet e noterisë. Banorëve të Istogut do t'u duhet të udhëtojnë mbi 20 kilometra sepse noterët e autorizuar për të kryer shërbimet për istogasit ndodhën në Pejë. Ministria e Drejtësisë disa herë ka premtuar që menjëherë pas miratimit të ligjit, do t'a bëjë zgjidhjen e këtij problemi.

**Pyetje:** z. Ministër, pse po diskriminohen banorët e Istogut nga kjo e drejtë ligjore?



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOSOVËS  
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVO  
ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Zyra për Propozime dhe Përditësim-Korrigjime të Propozimeve dhe Propozitave të Tërësishme

Nr. Prot. 06/2826/D<sub>0</sub>-1939  
B. Prot. Prot. No.  
Nr. i Regjeve 11.02.2019  
B. Prot. Prot. No.  
No. pages. 11.02.2019

PRISHTINE


Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Ekrem Mustafa, Ministër i Punëve të Brendshme.	<b>DATE DATU M DATE</b>	08.02.2019
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Armend Zemaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës		
<b>SUBJE KTI PREDM ET SUBJE CT</b>	Pyetje parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:** Policia e Kosovës në raport me perceptimin dhe besueshmërinë e opinionit publik ishte në nivel më të lartë para ardhjes së kësaj qeverie në pushtet. Me ndërhyrjet e dyshimta për motive politike, kjo besueshmëri çdo ditë e më shumë po zvogëlohet.

**PYETJA:** Çfarë po bëni ju si Ministër në mënyrë që Policia e Kosovës të jetë e pavarur, e besueshme për qytetarët e vendit, dhe në zbatim të plotë të ligjit.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Ramush Haradinaj, Kryeministër i Republikës së Kosovës.	<b>DATE DATU M DATE</b>	08.02.2019
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Armend Zemaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës <i>Armend Zemaj</i>		
<b>SUBJE KTI PREDM ET SUBJE CT</b>	Pyetje parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:** Në programin tuaj qeverisës, në një ndër objektivat kryesore e keni proklamuar fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, si njohje të reja dhe anëtarësim në organizatat ndërkombëtare e rajonale.

**PYETJA:** Sa njohje ka marrë Kosova prej që është mandatuar kjo Qeveri nën udhëheqjen e juaj? Po ashtu, në cilat organizata ndërkombëtare dhe rajonale është anëtarësuar Kosova, gjatë këtij mandati qeverisës?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO  
NEW YORK  
REPUBLIC OF KOSOVO  
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVO  
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO  
06/2899/90/485  
25-02-2019

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Ministrin e Shëndetësisë Z. Uran Ismajli</b>	<b>DATE DATUM DATE</b>	<b>25.02.2019</b>
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Besa Baftiu, deputete e Grupit Pralamentar PSD</b>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<b>Pyetje për përgjigje me gojë</b>		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


Çështja:

I nderuar minister Ismajli, studentët e Luginës së Preshevës të cilët kanë përfunduar studimet në lëmin e mjekesisë dhe infermierisë në Universitetin e Prishtinës nuk po ju mundësohet marrja e licencës nga odat e profesionistëve shëndetësor . Paisja me licencë sic dihet është obligative për të filluar punën qoft si mjek apo infermier.

Mjekët dhe infermieret nga Lugina e Preshevës shumë here ju kanë drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë për të bërë një zgjidhje në këtë drejtim por ka vite që po presin.

**Pyetja Parlamentare**

Z. minister pse nuk po ju mundësohet mjekëve dhe infermiereve nga Lugina te paisen me licencë?



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR/ZA/TO</b>	Z. Ekrem Mustafa Ministër i Punëve të Brendshme	<b>DATE DATUM DATE</b>	25.02.2019
		Reference	
<b>NGA/OD/FROM</b>	Aida Dërguti Deputete e GP-Partia Socialdemokrate		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		


Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Vonesa e heqjes së dënimeve nga sistemi për menaxhimin e gjobave të komunikacionit

Pyetja Parlamentare

I nderuari Ministër, siç jeni në dijeni, sistemi për menaxhimin e gjobave të komunikacionit është duke u bërë problem i madh për qytetarët për arsye se dënimet nuk e pasqyrojnë realitetin. Të dhënat nuk përditësohen me më të rejtat e fundit, edhe pse qytetarët i paguajnë gjobat.

Pyetja ime është: a jeni në dijeni për këtë problem? Nëse po, çka keni ndërmarrë për evitimin e tij?



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

<b>PËR / ZA / TO</b>	<i>Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Shyqyri Bytyçi</i>	<b>DATE DATUM DATE</b>	28.02.2019
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Deputetja Sala Berisha Shala	<i>[Signature]</i>	
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika (2) e Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Keni deklaruar që cilësia në arsim është prioritet, mirëpo nuk po mendoj se këtë prioritet e keni llogaritur mirë.


Ditë më parë, maurantet e gjimnazit nga komuna e Drenasit vizituan Kuvendin e Kosovës të cilët veç tjerash shprehen shqetësimin për ndryshimin e testit të maturës për këtë vit shkollor.

Gjenerata e maurantëve të cilët në vitin shkollor 2018/2019 e përfundojnë maturën, që nga klasa e gjashtë u janë nënshtruar reformave në çdo vit shkollor, gjë që domosdoshmërisht do të ndikoj në rezultatet dhe sukseset e tyre. Po kjo gjeneratë, po atakohet tani edhe me ndryshimet në testin e maturës për çka nuk janë informuar me kohë që të arrijnë përgatitjet.

Pyetja:

Z. Ministër, kur keni menduar që të bëni ndryshime në testin e matures, a e keni patur për bazë këtë fakt, si dhe pse nuk i keni ndërmarrë veprimet për ndryshim më herët që maurantët të kenë mundësi të përgatiten me kohë për testin e maturës?





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë	<b>DATE DATUM DATE</b>	27.02. 2019
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Haxhi Avdyli, <i>Deputet i LDK-së</i>		
	<i>Pyetje Parlamentare</i>		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:** Kërkimi i llogaridhënies nga Ministria e Shëndetësisë për masat e marra të lidhura me gjendjen epidemiologjike pas vdekjeve nga Gripi

**Pyetja parlamentare:** z. Ministër, siç e dini ka një numër të madh të prekurve nga gripi në Kosovë, ka edhe raste të vdekjeve nga kjo epidemi. Sa ju si Ministër dhe institucionet jeni preokupuar me zbutjet e pasojave të kësaj epidemie. Pse nuk është siguruar asnjë dozë e medikamentit Tamiflu, që ordinohet për këto raste. Pse jeni vonuar me sigurimin e vaksinave kundër gripit, si dhe pse Klinika infektive dhe e mushkërive në pikën e epidemisë janë në renovim?.



Pratje Nr. 06/2931/D-1511
Data 01.03.2019
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	<i>Kryeministrin e Kosovës z. Ramush Haradinaj</i>	<b>DATE DATUM DATE</b>	01.03.2019
<b>NGA / OD / FROM</b>	<i>Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli</i>	<i>Mexhide MJAKU TOPALLI</i>	
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Ndërtimi i hidrocentralit 3 ka filluar në vitin 2017 pasi që është publikuar fillimi i fizibilitetit të projektit të Lepencit. Granti është fituar në dhjetor të vitit 2016 projekti më strategjik dhe zhvillimor për Kosovën.

Me fillimin e ndërtimit të mini-hidrocentraleve në lumin e Lepencit(hidrocentrali Vica dhe hidrocentrali Lepenci 3 afër Firajës që është duke u ndërtuar),parashtrohet pyetja se a po vihet në pikëpyetje realizimi i projektit të Lepencit.

PYETJE :

I nderuari Kryeministër:

Ju lutem të na jepni informacione se a janë të paisur me leje përkatëse për ndërtimin e këtyre mini-hidrocentraleve dhe nga kush janë lëshuar këto leje, fjala është në lumin Lepenc.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI / REPUBLICAN ASSEMBLY  
KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
PRISTINE / PRISTINA

Pr. Pr. / Pr. No. 06/2936/06-15/15  
Data / Date 05.03.2019  
PRISTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Abelard Tahiri, Ministër i Drejtësisë	<b>DATE DATU M DATE</b>	04. 03. 2019
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Salih Zyba, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJE KTI PREDM ET SUBJE CT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


**ÇËSHTJA**

Në sistemin e drejtësisë, në Gjykata dhe Prokurori (por edhe në Polici), rastet e hapura dhe në procedurë, nuk janë duke funksionuar në një sistem unik të një baze të të dhënave. Qytetarët për të nxjerrë një dokument që kërkohet nga shumë institucione vendore dhe ndërkombëtare, qoftë për viza, apo për punësim në konkurse, detyrohen që me ditë të tëra të enden nëpër këto institucione për të mbyllur një rast përkundër që janë të përfunduara shumë kohë më parë.

**PYETJE PARLAMENTARE**

z. Ministër, kur do të ketë një zgjidhje të duhur për këtë problematikë?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Bedri Hamza, Ministër i Financave	<b>DATE DATU M DATE</b>	05.03.2019
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Salih Zyba, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

#### ÇËSHTJA

Janë bërë 3 muaj prej se është vendosur tarifa 100 përqind për produktet nga Serbia dhe Bosnja. Tashmë zbatimi i saj duhej të ishte i plotë. Por nuk po ndodh kështu. Ka shumë lëshime në zbatim. Pikat e shitjes janë plot me mallra nga Serbia. Ka pasur edhe denoncime publike se është rritur kontrabanda. Sipas linjës së përgjegjësive në këtë mes janë përgjegjës Ministria e Financave dhe institucionet në varësi si Doganat dhe Antikontrabanda.

#### PYETJE PARLAMENTARE

Pra z. Ministër, kush po e lejon konkretisht kontrabandën dhe rritjen aktuale të saj? Cilat biznese dhe produkte të liruara nga taksë 100% ishin në pritje të zhdoganimit kur hyri taksë në fuqi? Sa ishte vlera e taksës që nuk u pagua dhe nga kush erdhi kërkesa për lirim të tyre dhe kush vendosi t'i liri?



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOSOVSKA REPUBLIKA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
Kuvendi i Republikës së Kosovës  
Assembly of the Republic of Kosovo  
Prishtinë - Pristina

№/IDRI  
IDRI NO 06/2939/06-1517

Data  
Datum  
Date 05.03.2019

PRISHTINË PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Ministrin e Shëndetësisë Z. Uran Ismajli</b>	<b>DATË DATUM DATE</b>	<b>05.03.2019</b>
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Besa Baftiu, deputete e Grupit Pralamentar PSD</b>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<b>Pyetje për përgjigje me gojë</b>		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


**Çështja:**

I nderur minister Ismajli, në programin qeverises 2017-2021 , objektivë e ministrise së shëndetesisë është ruajtja dhe përmisimi i shëndetit të populates. Në këtë drejtim keni potencuar ndër të tjera të zbatoni programet e Skreningut që është njëra ndër metodat më të shpejta dhe të sigurta të dedektimit të sëmundjeve dhe çrregullimeve te ndryshme metabolike në fazën e hershme të zhvillimit të sëmundjes.

**Pyetja Parlamentare**

Çka keni ndermarrë në këte drejtim?

Në vecanti a është duke u punuar që të bëhet skreningu neonatal sepse është shumë e rëndesishme që përmes Skreningut neonatal të zbulohet prezenca e te disa sëmundjeve apo çrregullimeve matabolike të lindura të cilat nëse nuk diagnostifikohen dhe trajtohen me kohë mund të japin dëmtime të rënda organike e në raste të rënda qojne edhe ne vdekje te hershme?



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Ramush Haradinaj - Kryeministër i Republikës së Kosovës	<b>DATË DATUM DATE</b>	05.03.2019
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Arbër Rexhaj - deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


**ÇËSHTJA: Cenimi i integritetit territorial të vendit**

Në fshatin Karaçevë të Kamenicës, në rrugën që lidh fshatrat lokale hynë xhandarmëria serbe. KFOR-i dhe Policia e Kosovës kanë krijuar një rrugë alternative nga arat e këtyre fshatrave për të mos kaluar atë rrugë të cilën defakton e njohin Serbi.

**PYETJA**

A jeni në dijeni lidhur me këtë çështje?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Ramush Haradinaj - Kryeministër i Republikës së Kosovës	<b>DATE DATUM DATE</b>	05.03.2019
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Arbër Rexhaj- deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**ÇËSHITJA: Demarkacioni me Malin e Zi**

Kuvendi i Kosovës ka miratuar delimitimin e kufirit me Malin e Zi, duke i lënë jashtë 8200ha tokë.

Ju keni thënë se bashkë me Qeverinë Malazeze do të rishikoni këtë marrëveshje, duke pretenduar se do ti ktheni 8200ha tokë të falur.

**PYETJA**

I nderuar Kryeministër,

A keni filluar së paku të mendoni për këtë?




ARBITRAZH I KURTORIT PARLAMENTAR  
Kuvendi i Kosovës  
Prishtinë, Kosovë

06/2942 / 06-1521

05.03.2019

PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Ramush Haradinaj Kryeministër i Republikës së Kosovës	<b>DATE DATUM DATE</b>	05.03.2019
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Albulena HAXHIU, deputete e Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		


Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

#### ÇËSHTJA

Më datë 29.05.2018 keni marrë vendim për caktimin e lokacionit për “ndërtimin e objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme”, në Kosovë, Vendimi me Nr. 11/49.

#### PYETJE PARLAMENTARE

Pse keni marrë këtë vendim?



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Uran Ismaili Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë	<b>DATE DATUM DATE</b>	25.01.2019
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Fatmire Kollçaku- deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**ÇËSHTJA**

*Lista esenciale e barnave*

**PYETJA**

I nderuar, Z. Ministër,


Në cilën fazë është përpilimi i listes esenciale. A është afër përfundimit i saj.

A po mirren për bazë sygjerimet e doktorave të cilët kanë vërejtje gjatë procesit?

Fatmire Kollçaku

Deputete e Lëvizjes VETËVENDOSJE!





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Valdrin Lluka, Ministër Zhvillimit Ekonomik	<b>DATE DATUM DATE</b>	05.03.2019
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Arbërie Nagavci, deputete e Lëvizjes VETËVËNDOSJE! <i>Arbërie Nagavci</i>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

### ÇËSHTJA

Jemi dëshmitarë se muajt e fundit, më saktësisht vitin e fundit kanë vazhduar goditje të rënda në Telekomin e Kosovës që kanë shkaktuar gjendje të krizës në këtë ndërmarrje.

Ndonëse Kompanitë e Telekomunikacionit gjithandej janë shumë fitimprurëse, madje për disa vite edhe vet Telekomin e Kosovës ka qenë shembull për të mirë për të hyrat dhe avancimet e produkteve, tashmë ai qëllimshëm është sjellë në gjendje sa nuk mund t'i mbulojë as shpenzimet e veta rrjedhëse;

Ndër metodat dhe sulmet më agresive në shkatërrim të Telekomit nga Qeveria aktuale, është rritja e numrit të të punësuarve, kryesisht me punësime të familjarëve dhe militantëve partiakë në Telekomin e Kosovës.

Përveç tjerash këtu mund të ketë ndikuar dhe deklarimit i ministrit të MZHE-së që pas privatizimit, punëtorëve do tu ofrohet një pako sociale për ata që ata që e lënë punën me vetë dëshirë, e që do të përfitojnë 5 deri në 20 mijë euro.

Pas ngritjes së shqetësimit për nivelin alarmues të punësimeve në Telekom nga LV! si dhe një varg raportimesh të mediave, kryetarja e Bordit të Drejtorëve, i ka dërguar një raport ministrit të Zhvillimit Ekonomik, për të arsyetuar rritjen e numrit të punëtorëve, ku në tabelën e punësimeve vërehet rritja e numrit të punëtorëve për 234 persona në periudhën shkurt 2018- shkurt 2019. Në total në këtë periudhë Telekom i ka 2540 punëtorë, për dallim prej 2295 sa kishte në vitin 2016.

Përkundër këtyre punësimeve masive, ku vetëm vitin e fundit janë punësuar mbi 200 persona dhe është rritur 8.5% numri i të punësuarve në ndërmarrje, gjatë 2018 në bazë të publikimeve të ARKEP-it, dëshkohet se sipas të hyrave dhe përdoruesve, Telekom i ka shënuar rënie.

### **PYETJE PARLAMENTARE**

z. Ministër, a mund të na tregoni se çfarë keni ndërmarrë gjegjësisht do të ndërmerrni në raport me këtë shkelje?

Për më shumë si do ta adresoni përgjegjësinë për këto shkelje?



REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA E KOSOVËS  
YQHANI E REPUBLIC OF KOSOVO  
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO  
Kuvendi i Propozime, Propozime, the Propozime-Kuvendinija za Predloga: Preustavke-Table Office

Pr. No. 06/2952/10-1531

Date: 05.03.2019

PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

<b>PËR / ZA / TO</b>	Kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj	<b>DATE DATU M</b>	05.03.2019
		<b>DATE Reference</b>	
	Avdullah Hoti - Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së		
<b>SUBJE KTI PRED MET SUBJE CT</b>	Pyetje parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:** Në seancën e datës 21 mars 2018, me rastin e ratifikimit të Marrëveshjes së Demarkacionit të kufirit në mes të Republikës së Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës, ju patët deklaruar : “Jam i bindur se marrëveshja ndërmjet dy presidentëve dhe të gjeturat e Komisionit shtetëror e plotësojnë marrëveshjen e nënshkruar më 2015 dhe krijojnë bazë të pakontestueshme ligjore për korrektimin e gabimeve të bëra në procesin paraprak, posaçërisht në drejtim të Kullës dhe Çakorrit, siç është specifikuar edhe në ankesë marrëveshjen e presidentëve...”

**PYETJA:** Në cilën fazë gjendet çështja e “ korrektimit të gabimeve” në drejtim të Kullës dhe Çakorrit? Pse ka qenë e nevojshme që edhe me buxhetin e këtij viti të ndahen mjete për Komisionin Shtetëror për Shënimin e Vijës Kufitare me Malin e Zi?





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA  
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO  
Zyra për Propozime dhe Parashtrime - Kancelaria e Propozimeve dhe Propozimeve  
No. Prop. 06/3005/10-1572  
Prof. No.  
Data 18.03.2019  
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Ministrin e Punëve të Brendshme</b> z. Ekrem Mustafa	<b>DATE</b> <b>DATUM</b> <b>DATE</b>	18.03.2019
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Dardan Sejdiu, deputet i GP të PSD-së.		
<b>SUBJEKTI</b> <b>PREDMET</b> <b>SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Z. Ministër,


Numri i aksidenteve në komunikacion, të cilat po rezultojnë me humbje të jetës së njerëzve, cdo dite e më shumë është në rritje.

Rastet e raportuara për humbje të jetëve njerëzore si pasojë e aksidenteve rrugore po bëhen tepër shqetësuese për të gjithë.

### Pyetja Parlamentare

Z. Ministër,

A ka ndonjë raport vjetor për arsyet e shkaktimeve të aksidenteve me vdekje dhe a e keni idenë apo informacionin e saktë për shkaktarët e fatalitetit!?



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

<b>PËR / ZA / TO</b>	Behxhet Pacolli Ministër i Punëve të Jashtme	<b>DATE DATUM DATE</b>	05.04.2019
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Aida Dërguti Nëkryetare e Kuvendit		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:** Tërheqja e njohjeve

**Pyetja parlamentare:** I nderuari Ministër, z. Pacolli, a mund të na tregoni se a e ka tërheqë Norvegjia njohjen për Shtetin e Kosovës?



REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI - REPUBLIC OF KOSOVO  
SKUPŠTINA - REPUBLIC OF KOSOVO  
ASSEMBLY - REPUBLIC OF KOSOVO  
Zyra për Propozime dhe Përcaktim të Kancelarijës së Presidencës - Prishtinë - Table Office

No. Prot. / Bi. Prot. / Prot. No. *06/3108/10-1627*

No. i faqes / Broj stranice / No. pages *10-04-2019*

Date / Datum / Date *10-04-2019*

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly


<b>PËR / ZA / TO</b>	Kryeministrin Ramush Haradinaj	<b>DATE DATUM DATE</b>	10.04. 2019
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Shqipe Pantina, deputete e GP të Partise Socialdemokrate! <i>Shqipe Pantina</i>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**PYETJE**

I nderuar Kryeministër,  
Kur do ta sillni në Kuvend Ligjin për Qeverinë?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	Kryeministrin Ramush Haradinaj	<b>DATE DATUM DATE</b>	10.04. 2019
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Shqipe Pantina, deputete e GP të Partise Socialdemokrate! <i>Shqipe Pantina</i>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		


Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**PYETJE**

I nderuar Kryeministër,

Qyteti i Klinës është ndër të paktët e ndoshta i vetmi qytet i cili ende nuk e ka të rregulluar çështjen e ujit të pijshëm. Përkundër investimeve milionësh cshtja e ujit të pijshëm ende nuk është zgjidhur. Komuna vetë nuk ka kapacitet për ta zgjidhur këtë problem prandaj i duhet ndihma e qeverisë.

A ka qeveria plan të rregulloj problemin e ujit të pijshëm në Klinë, nëse po cili është plani dhe kur pritet të realizohet?



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. <i>Rrustem Berisha</i> , Ministër i Mbrojtjes	<b>DATE DATUM DATE</b>	10.04.2019
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Xhelal Sveçla, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**ÇËSHTJA**

Struktura e Ministrisë së Mbrojtjes

**PYETJE PARLAMENTARE**

Ministër, kur do të miratohet struktura e Ministrisë së Mbrojtjes dhe kur do të filloj nga zbatimi?